

Kumtesë nga ISHP

Të nderuar,

ISHP është në koordinim të vazhdueshëm me Inspektoratin e Mjedisit Jetësor, Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucione të tjera kompetente shtetërore. Dje, ISHP dërgoi një ekip ekspertësh të trajnuar nga Instituti për kontroll të jashtëzakonshëm në zonën e prekur.

U morën mostra të ujit, tokës dhe ajrit për testim të radioaktivitetit , si dhe mostra nga uji, ujësjellësi, puset, toka për analiza fizike dhe kimike.

Gjatë ditës së sotme në ISHP u nxorën rezultate të analizës së ajrit dhe tokës, nga mostrat për testim të rrezatimit jonizues (radiacionit) dhe ato janë brenda vlerave normale referente, pa devijim.

Rezultatet e mostrave të ujit për testimin e rrezatimit jonizues, sipas metodës së përdorur për testim, do të jenë të disponueshme nesër.

Në mostrat e ujit për sa i përket analizës fizike dhe kimike, nuk ka devijime në vlerat për sa i përket metaleve të rënda. Në mostrat e ujit ka vetëm një indikator për përmbajtjeje të shtuar të substancave organike në ujërat nëntokësore që janë me origjinë tjetër.

Sa i përket mostrave të marra nga toka për prani të metaleve të rënda, rezultatet sipas metodës së testimit do të jenë të disponueshme gjatë ditës së nesërme.

Me respekt,

ISHP